



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:215297

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05511606

P.nr.1052/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – Departamenti i pergjithshem penal, gjyqtari i vetëm gjykues Fatmir Krasniqi, me sekretaren juridike Fatime Bajraktarin, në lëndën penale kundër të akuzuarit **J.V.**, nga Gjakova, me mbrojtësin e tij **av.Xh.E.,n** nga Prizreni, për shkak të veprës penale ngacmimi nga neni 182 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi nr.06/L-074), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore të shtetit në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm penal PP/II.nr.993-11/2023, të datës 11.10.2023, pas mbajtjes së seancës gjyqesore publike të shqyrtimit fillestar, në prezencën e Prokurorit themelor të Shtetit në Prizren, Mehrem Hogja, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, të demtuarës, gjykata mori dhe publikisht shpalli me datë **19.03.2024** këtë:

A K T G J Y K I M

J.V., nga i ati, e ëma, e vajzërisë, i lindur më, në Gjakovë, ku edhe tani jeton, në lagjen e rr.pnr, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i martuar baba I 4 femijeve, i gjendjes së dobët ekonomike, egjiptian, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.pers.,

ËSHTË FAJTOR

Se nga data e pavërtetuar e në vazhdimësi deri më 13.06.2023 në rr. “ “ në Prizren, i pandehuri J.V., me dashje përfshihet në sjellje të vëmendjes së vazhdueshme dhe të padëshirueshme, me qëllim të ngacmimit dhe frikësimit ndaj të dëmtuarës N. Gj., në atë mënyrë i pandehuri me të dëmtuarën paraprakisht kishin qenë në lidhje mes veti dhe pas shkëputjes së lidhjes, i pandehuri në vazhdimësi e vë nën vëzhgim të dëmtuarën duke e përcjellë, e cila me datën e lartpërmendur pasi del nga shtëpia për një moment në rrugë i del përpara i pandehuri i cili e ndal të dëmtuarën dhe të njëjtës i drejtohet me fjalët “ *kam gabuar dhe vetëm vdekja më ndan nga ti* ” e cila pas këtyre fjalëve largohet nga vendi i ngjarjes, ku i pandehuri më vonë përmes telefonit të dëmtuarës i shkruan SMS me fjalët “ *kam me luajt*

mendsh pa ty”, si rrjedhojë e këtyre veprimeve tek e dëmtuara e lartpërmendur shkakton shqetësim, frikë dhe pasiguri të madhe për jetën e saj personale.

Me këto veprime ka kryer veprën penale: Ngacmimi nga neni 182 par.1 i Kodit nr.06/L-074 Penal të Kosovës

Andaj, gjykata në kuptim të nenit të lartëshënuar dhe neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 70, 71, e 72 të KPK-së, e nenit 182 par.1 të KPRK-së si dhe nenit 364 të KPPK-së, të akuzuarit ia shqipton:

DËNIMIN ME GJOBË

Në shumë prej **300,00 € (treqindë) euro**, të cilin dënim me gjobë i akuzuari është i obliguar që të e paguajë, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, denimin me gjobe i akuzuari do ta paguaje ne 3 kiste, nëse në afatin e caktuar ligjor i njeiti nuk do të e paguajë dënimin me gjobë as me ekzekutim, i njeiti dënim do të zëvendësohet me dënim burgimi dhe atë për 20 euro, një ditë burgim, respektivisht 15 dite burgim.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej **20 € (tridhjetë euro)** si dhe në emër të taksës për kompenzimin e viktimave të krimit shumën prej **20 € (njezetë euro)**, të gjitha këto në afatin prej **15 (pesëmbëdhjetë) ditësh** nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

E dëmtuara **N. A. Gj.**, nga Prizreni, rr..... nr....., për realizimin e kërkesës pasurore - juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.993-11/2023, të datës 11.10.2023, kundër të akuzuarit J.V., nga Gjakova, për shkak të veprës penale ngacmimi nga neni 182 parag. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi nr.06/L-074).

Gjykata në shqyrtim fillestar gjyqësor ka vërtetuar gjendjen e këtillë faktike nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, i cili vullnetarisht e ka pranuar fajësinë, për shkak të së cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare, gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e papranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë, e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzime, duke u mbështetur në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 242 par.1 e 2 nënpar.2.1, 2.2 e 2.3 e 2.4 të KPPK-së, dhe faktet që përmban aktakuza, ne veprimet e të akuzuarit formohen te gjitha elementet e veprës penale të ngacmimit nga neni 182 parag. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, për këtë gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi denimin me gjobë si të merituar, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo-juridike.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 69 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke mos gjetur rrethana posaqerishte rënduese, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Gjkata si rrethana lehtësuese, ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pranimi i fajësise është bere vullnetshem pa presion e as pa ndikim nga jashte, në kuptim të dispozitave të nenit 70, 71, 72, të KP-së, gjykata mori për bazë edhe faktin se i akuzuari ka bashkëpunuar me gjykatën, bashkëpunimi i tij ka qenë vullnetar në hetimin dhe ndjekjen penale, të kryerësve të tjerë të veprave penale, i akuzuari ka pasur sjellje korrekte para gjykatës, publikisht i kërkon falje të demtuaries, në një formë është i penduar për këtë vepër penale të kryer, i premton gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë edhe njëherë këtë vepër penale, është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, tani e tutje asnjehere me nuk do ta shqetesoje e as nuk do ta pengojë të demtuaren, andaj gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar është e pritshme të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 të KP-së dhe se ky dënim është në proporcion me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, rrethanat dhe mënyrën e kryerjes si dhe personalitetin e të akuzuarit dhe se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm dhe të përmbahet nga veprimet e tilla të karakterit penalo-juridik, si dhe një dënim i tillë do t'i ndikojë si preventive të i akuzuari që të mos perserise vepra penale dhe të risocializohet në shoqëri, dhe parandalojë edhe personat e tjerë nga kryerja e veprave penale të kësaj natyre.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 452 të KPP-së.

Vendimi mbi kompenzimin e viktimave të krimit është marrë në kuptim të nenit 39 par.3 pika 1 të ligjit nr.05/L-036.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
Departamenti i pergjithshem penal
P.nr.1052/2023 datë 19.03.2024

Sekretare juridike
Fatime Bajraktari

Gjyqtari
Fatmir Krasniqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimin të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.

Numri i lëndës: 2023:215297
Datë: 27.03.2024
Numri i dokumentit: 05511606